



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 27.07.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1263/23, për zyrtarin e lartë z. **Fehmi Kupina**, Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, për shkak se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi/papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Fehmi Kupina, Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, sipas të cilit z. Kupina duke qenë zyrtar i lartë publik, njëkohësisht ka mbajtur edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat ("Fehmi Kupina B.I."), situatë kjo e cila bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Lidhur me këtë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-1281/23), e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga z. Kupina, i njëjti ka kontaktuar Agjencinë, për tu njoftuar më në detaje lidhur me situatën e konfliktit të interesit apo papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik. Me këtë rast, Agjencia e ka njoftuar atë se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.”

Zyrtari i lartë, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit apo papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pranuar informacione (Dep-06-1281-1/23) me dokumentet përcjellëse (informatat e biznesit), në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë, ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1. dhe 1.3. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat.

Me veprimet e ndërmarra nga z. Kupina, është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarët e lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Ylli Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit